

AKT NORMATIV
Nr.10, datë 26.3.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998, “PËR TATIMIN
MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Neni 1

Pas pikës 9, të nenit 38 “Dispozita kalimtare”, shtohet pika 10, me këtë përmbajtje:

“10. Përfshihet nga parashikimet e neneve 29 dhe 30, të këtij ligji, për deklarimin dhe pagesën e tatimit mbi fitimin, në vitin 2020, afatet e deklarimit dhe të pagesës janë, si më poshtë vijon:

a) Bilanci kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo e dhënë tjetër e përcaktuar në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat, në zbatim të këtij ligji, dorëzohet brenda datës 31 korrik 2020;

b) Për tatimpaguesit me qarkullim deri në 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, tatimi i llogaritur në bazë të deklaratës vjetore të të ardhurave të tatueshme, pakësuar me shumën e përcaktuara sipas nenit 37, të këtij ligji, dhe me parapagimet e bëra gjatë periudhës tatimore, paguhet nga tatimpaguesi në llogarinë e organeve tatimore, brenda gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2020;

c) Për tatimpaguesit me qarkullim deri në 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, këstet e tatim-fitimit të tremujorit të parë dhe të dytë të vitit 2020, parapagohen në llogarinë e organeve tatimore, brenda datës 31 dhjetor 2020. Këstet paraprake të tatimit mbi fitimin, të tremujorit të tretë dhe të katërt të vitit 2020, parapagohen në llogarinë e organeve tatimore, brenda datës 31 dhjetor 2020.”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama